MINISTRIA E EKONOMISE, TREGETISE DHE ENERGJITIKES
Drejtoria e Përgjithshme e Hidrokarbureve

U R D H E R

Nr. 184 Datë 5 . 07 . 2005

"Për miratimin e kushteve teknike dhe normave të projektimit për impjantet dhe instalimet që shërbejnë për transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve ~~14, 15~~ dhe 16 të Ligjit nr. 8450 datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, dhe të pikës 1 të kreut të vendimit nr. 170, datë 25.04.2002 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e proçedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve ~~e të autorizimeve~~ për tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar.

U R D H E R O J :

1. **Kushtet teknike dhe normat e projektimit të impianteve, instalimeve dhe pajisjeve që shërbejnë për transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, miratohen sipas tekstit të studimit bashkëngjitur këtij urdhëri.**
2. Qëndra Kombëtare Shkencore e Hidrokarbureve dhe Inspektoriati Shtetëror i Kontrollit të Naftës, gazit dhe Nënprodukteve të tyre, brënda datës 30.09.2005 të bëjnë publikimin e kushteve dhe normave teknike të përcaktuara sipas pikës 1 të këtij urdhëri, duke bërë dhe përcjelljen e tij pranë organeve përkatëse, që janë ngarkuar me projektimin ose dhënien e lejeve për ndërtimin dhe përdorimin e depozitave, impianteve dhe instalimeve për depozitimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, si dhe për kontrollin e zbatimit të kushteve teknike dhe normave të projektimit.
3. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen Drejtoria e Përgjithëshme e Hidrokarbureve, Inspektoriati Shtetëror i Kontrollit të Naftës, gazit dhe Nënprodukteve të tyre dhe Qëndra Kombtare Shkencore e Hidrokarbureve.
4. Për subjektet dhe institucionet që nuk zbatojnë kërkesat e këtij Urdhëri, nga organet kompetente do të vendosen sanksione në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. **Urdhëri Nr. 182, datë 09.04.2001** "Për miratimin e kushteve dhe normat teknike për depozitimin dhe tregtimin e karburanteve të lëngëta", **Urdhëri Nr. 184, datë**

15.07.2002 "Për miratimin e kushteve teknike dhe normave të projektimit për stacionet e shitjes së karburanteve për automjete (benzinë, gazoil) brënda vijave të verdha të qytetit dhe zonave të banuara si dhe për gazin e lëngëzuar të naftës", **"Urdhëri Nr. 40, datë 09.02.2004** "Për miratimin e kushteve teknike dhe normave të projektimit të impianteve të gazit të lëngëzuar të naftës (G.L.N.) për përdorim vetjak e kolektiv dhe furnizimin e automjeteve" dhe **Urdhëri Nr. 41, datë 09.02.2004** "Për miratimin e kushteve teknike dhe normat e projektimit për stacionet qëndrore të naftës dhe tubacioneve magjistraleve të naftës dhe gazit" shfuqizohen.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Dv Viktor DODA